

UDHËZIM
Nr. 27, datë 13.9.2023

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 30.1.2015,
“PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 2, “Përkufizime të përgjithshme” bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 10 shtohet pika 10/1 me këtë përmbajtje:

“10/1. Program i financuar nga asistenca financiare e Bashkimit Evropian është një plan veprimi vjetor ose shumëvjeçar i miratuar nga Komisioni Evropian për zbatimin e asistencës financiare IPA për Republikën e Shqipërisë, duke përcaktuar objektivat, rezultatet e pritshme, aktivitetet kryesore, metodat e zbatimit, buxhetin dhe treguesit, afatin kohor, të gjitha veprimet mbështetëse të lidhura dhe metodën për monitorimin e rezultateve të zbatimit të programit.”.

b) Në fund të pikës 11 shtohen fjalët: “...projektet e përcaktuara në programe/protokolle bashkëpunimi apo dokumente strategjike.”.

Neni 2

Neni 63/1, “Procedura e përjashtimit në import dhe trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet për marrëveshjet e donacionit/grantit” riformulohet si më poshtë:

“Neni 63/1

Procedura e përjashtimit në import dhe trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet për marrëveshjet e donacionit/grantit me donatorët, përveç granteve nga Bashkimi Evropian

1. Në zbatim të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 60, të ligjit, për qëllime të TVSH-së, trajtohet si furnizim i ngjashëm me eksportet, furnizimi i mallrave/shërbimeve, të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshjeje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për të paguar tatime në Shqipëri.

2. Për të siguruar trajtimin me shkallën tatimore të TVSH-së zero për qind, zbatuesi ose përfituesi i projektit (kur nuk ka zbatues), duhet të regjistrohet për qëllime të TVSH-së dhe të ndjekë procedurën e mëposhtme:

2.1 Regjistrimi në organin tatimor për efekt të TVSH-së i zbatuesit/përfituesit (kur nuk ka zbatues)/kontraktorit të projektit

Në mënyrë që skema e parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 60, të ligjit të funksionojë, duhet që zbatuesit/përfituesit (kur nuk ka zbatues)/kontraktorët, të jenë të regjistruar për TVSH-në. Regjistrimi për qëllime të TVSH-së mundëson lëshimin e faturave tatimore me TVSH zero për qind për furnizime brenda vendit nga kontraktorët, si dhe pranimin e këtyre faturave nga zbatuesit/përfituesit e projektit. Regjistrimi për TVSH-në mund të bëhet edhe nëpërmjet përfaqësuesit tatimor, sipas dispozitave të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar.

2.2 Në zbatim të pikës 1, regjistrimi i zbatuesit/përfituesit të projektit në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAC) bëhet:

a) Në rastin e marrëveshjeve/protokolleve të bashkëpunimit të firmosura nga titullari i SASPAC, drejtoria përgjegjëse për bashkërendimin e ndihmës së huaj i drejton SASPAC kërkesën për regjistrimin dhe lëshimin e certifikatës për çdo projekt/program të parashikuar në përmbajtjen e tyre;

b) Në rastin e marrëveshjeve të përcjella nëpërmjet kanaleve diplomatike pranë SASPAC, drejtoria përgjegjëse për bashkërendimin e ndihmës së huaj i drejton SASPAC kërkesën për regjistrimin dhe lëshimin e certifikatës për çdo projekt/program të parashikuar në përmbajtjen e tyre;

c) Midis institucionit shqiptar përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj, ose zbatuesi i projektit ose përfituesi i projektit (kur nuk ka zbatues), regjistrojnë projektin në SASPAC, duke paraqitur:

i. Kërkesë me shkrim ku bashkëlidhur të jetë marrëveshja qeveritare kuadër e lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë apo Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverive të shteteve të huaja për sigurimin e bashkëpunimit financiar apo bashkëpunimit për zhvillim ndërmjet dy vendeve shoqëruar me protokollin e bashkëpunimit ose dokumentin strategjik të donatorit për mbështetjen e Shqipërisë (nëse ka një të tillë);

ii. Të dhëna referencë për aktin me të cilin është miratuar marrëveshja/protokolli/dokumenti strategjik (nëse ka një të tillë);

d) SASPAC vlerëson kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga zbatuesi/përfituesi i projektit dhe nëse është i plotë, lëshon Certifikatën e Regjistrimit të Projektit, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, SASPAC njofton menjëherë zbatuesin/përfituesin e projektit për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e tyre, brenda një afati 10-ditor (dhjetëditor);

e) Certifikata përmban elementet, si: emërtimi i projektit, data e fillimit dhe data e përfundimit të projektit, vlera fillestare e financimit të projektit, të dhënat e zbatuesit dhe përfituesit të projektit, si dhe Kodin Unik të Identifikimit të Projektit, të lëshuar nga SASPAC për këtë qëllim;

f) SASPAC, një kopje të certifikatës së regjistrimit të projektit, së bashku me kopje të dokumentacionit të parashikuar në shkronjën “a” më sipër, ia dërgon menjëherë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD);

g) Në rast të ndryshimit të kushteve të marrëveshjes dhe/ose projektit, zbatuesi/përfituesi i projektit duhet të njoftojë SASPAC, brenda një afati 5-(pesë-)ditor. Në këtë rast, SASPAC reflekton ndryshimet në certifikatën e lëshuar dhe ia dërgon menjëherë DPT-së dhe DPD-së;

h) Në rast të ndryshimit të vlerës së financimit dhe/ose projektit, zbatuesi/përfituesi i projektit duhet të njoftojë SASPAC, brenda një afati 5-(pesë-)ditor. Në këtë rast, SASPAC reflekton ndryshimet në certifikatën e lëshuar dhe ia dërgon menjëherë DPT-së dhe DPD-së;

i) DPT-ja dhe DPD-ja raportojnë në fundin e muajit pasues të çdo tremujori në SASPAC, të dhëna të detajuara për çdo transaksion që kanë kryer me TVSH-në e përjashtuar (të dhëna për zbatuesin/përfituesin e projektit, NIPT-i, kodi unik i certifikatës, vlera, monedha).

2.3 Regjistrimi i kontratës/ave në Drejtorinë Rajonale Tatimore (DRT) përkatëse:

a) DPT-ja, certifikatën e lëshuar nga SASPAC, së bashku me dokumentacionin e dërguar sipas shkronjës “d”, të pikës 2.2, më sipër, ia përcjell ditën e nesërme të punës, DRT-së ku është i regjistruar për TVSH-në i kontraktuari i zbatuesit të projektit ose zbatuesi/përfituesi i projektit;

b) Kontraktori/ët dorëzon/jnë pranë DRT-së ku është/janë i/të regjistruar një kopje të noterizuar të kontratës/ave të dakordësuar/a dhe nënshkruar/a me zbatuesin ose me përfituesin e projektit, për rastet kur ky i fundit nuk e delegon projektin tek ndonjë zbatues projektit.

DRT-ja përkatëse regjistron në një regjistër të veçantë kontraktorin/ët dhe/ose zbatuesin/përfituesin e projektit, si dhe brenda 5 (pesë) ditëve pune, lëshon certifikatën për efekt të trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet, sipas formularit 7A, pjesë integrale e këtij udhëzimi. Kjo certifikatë është e vlefshme deri në përfundimin e projektit, sipas kriterëve të parashikuara në marrëveshje;

c) Kodi Unik i Identifikimit të Projektit, i përcaktuar në certifikatën e lëshuar nga SASPAC, do të evidentohet në çdo faturë të lëshuar me TVSH zero për qind nga kontraktori për zbatuesin/përfituesin e projektit, si dhe në çdo faturë që furnizuesit e mallrave/shërbimeve (qofshin këto furnizime të tatueshme me TVSH apo të përjashtuara nga TVSH-ja) lëshojnë për kontraktorin e miratuar;

d) Në faturat që lëshon, kontraktori duhet të pasqyrojë dispozitën e ligjit, konkretisht, shkronja “c”, pika 1, neni 60, sipas së cilës ky furnizim do të trajtohet si furnizim i përngjashëm me eksportet, me shkallë tatimore të TVSH-së zero për qind, si dhe numrin e certifikatës së lëshuar nga DRT-ja. Ndërsa, furnizuesit e mallrave/shërbimeve për kontraktorin, qofshin këto furnizime të tatueshme me TVSH apo të përjashtuara nga TVSH-ja, do të pasqyrojnë në faturë numrin e certifikatës së lëshuar nga DRT-ja.;

e) Faturimi i furnizimeve të mallrave dhe shërbimeve kryhet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe në legjislacionin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

3. Aplikimi i TVSH-së gjatë zbatimit të projektit nga kontraktori

Kontraktori, subjekt i regjistruar për TVSH-në, në zbatim të kontratës së nënshkruar me zbatuesin e projektit, realizon furnizime mallrash/shërbimesh, të cilat sipas shkronjës “c”, pika 1, neni 60, të ligjit, trajtohen si furnizime të përngjashme me eksportet, pra me shkallë tatimore të TVSH-së zero për qind.

4. Deklarimi i transaksioneve për qëllime të TVSH-së nga kontraktori/ët dhe rimbursimi i TVSH-së së paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve

Kontraktori/ët, furnizimin e mallrave/shërbimeve të realizuara në zbatim të shkronjës “c”, pika 1, neni 60, të ligjit e deklarojnë në librin e shitjeve dhe më pas në formularin e deklarimit të TVSH-së në rubrikën “Shitje të përngjashme me eksportet”, ndërsa blerjet e realizuara për qëllim të kësaj skeme, në rubrikën “Blerje të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me donacione/grante”.

Për blerjet e kryera në funksion të realizimit të projektit, qofshin këto blerje me normë standarde apo të reduktuar të TVSH-së, kontraktori gëzon të drejtën e zbritjes së TVSH-së, sipas përcaktimeve në nenet 68–84, të kreut IX, të ligjit. Në rast se kontraktori rezulton me tepricë kreditore, i lind e drejta e rimbursimit, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Përjashtimi nga TVSH-ja në import

Në zbatim të pikës 45, të nenit 56, të ligjit, përjashtohen nga TVSH-ja në import, importimi i mallrave të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për të paguar tatime.

Për qëllime të zbatimit të përjashtimit në import, zbatuesi/përfituesi (kur nuk ka zbatues)/kontraktuesi i projektit, të cilët mund të kryejnë importe mallrash në kuadër të kësaj skeme, do të pajisen me autorizim nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave. Për marrjen e këtij autorizimi, zbatuesi/përfituesi/kontraktuesi i projektit duhet të paraqesë me shkrim pranë DPD-së:

a) Kërkesën për përjashtim nga TVSH-ja në importin e mallrave të destinuara për projektin;

b) Kopje të Certifikatës së Regjistrimit të Projektit, përfshirë Kodin Unik të Identifikimit të Projektit;

c) Kopje të certifikatës së lëshuar nga DRT-ja;

d) Kopje të noterizuar të kontratës/ave ndërmjet zbatuesit/përfituesit me kontraktorin/ët;

e) Dokumentin që vërteton përgjegjësinë tatimore të regjistrimit për qëllime të TVSH-së.

DPD-ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune, nga data e dorëzimit të kërkesës, shqyrton aplikimin për përjashtim dhe lëshon autorizimin nëse dokumentacioni është i saktë. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, DPD-ja njofton menjëherë subjektin aplikues për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e tyre, brenda një afati 10 (dhjetë) ditor. Me plotësimin e dokumentacionit, DPD-ja lëshon autorizimin për përjashtimin nga TVSH-ja në import. Ky autorizim regjistrohet në sistemin informatik të DPD-së.

6. Monitorimi dhe kontrolli i furnizimeve për llogari të projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshjeje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj

Administrata tatimore monitoron, analizon dhe verifikon furnizimet dhe importet e kryera në kuadër të skemës së parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 60, të ligjit nga:

a) Kontraktorët, të cilët aplikojnë TVSH zero për qind për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve për zbatuesit/përfituesit e projekteve;

b) Zbatuesit/përfituesit e projekteve, të cilët furnizohen me mallra dhe shërbime me TVSH zero për qind nga kontraktorët e tyre.

Administrata tatimore ka detyrimin e kontrollit, verifikimit, kryqëzimit të të dhënave të deklaruara nga kontraktorët/zbatuesit/përfituesit e projekteve në librat e tyre të shitjeve dhe blerjeve, si dhe në deklaratën e TVSH-së, me qëllim garantimin e trajtimit me TVSH zero për qind vetëm për furnizimet e parashikuara në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 60, të ligjit.

Procedurat e detajuara të verifikimit të transaksioneve, kontrollit të tyre dhe rimbursimit të kontraktorëve për rastet kur plotësohen kriteret ligjore, detajohen nga DPT-ja në pjesën e Manualit të Kontrollit të dedikuar për këto transaksione dhe subjekte.”.

Neni 3

Pas nenit 63/1, shtohet neni 63/2 me përmbajtjen si më poshtë:

“Neni 63/2

Procedura e përjashtimit në import dhe trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet për marrëveshjet e grantit për programet/projektet e financuara nga asistenca financiare e Bashkimit Evropian

1. Në rastin e programeve vjetore të financuara nga IPA Kombëtare, pas finalizimit të procedurave të brendshme për miratimin e Marrëveshjes së Financimit të Programit dhe hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, drejtoria përgjegjëse për administrimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian pranë SASPAC, në rolin e Zyrës Mbështetëse të Koordinatorit Kombëtar IPA, i drejton SASPAC kërkesën për regjistrimin dhe lëshimin e certifikatës për të gjithë dokumentet e veprimit që janë pjesë e programit të miratuar, duke i vënë në dispozicion:

a) Kopje të aktit të miratimit të Marrëveshjes Financiare të Programit;

b) Kopje të dokumentit/eve të veprimit për të cilat do të lëshohet certifikata.

Pas lëshimit të certifikatës, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, SASPAC ia përcjellë autoriteteve kontraktuese, respektivisht:

a) Për dokumentet e veprimit që do të zbatohen me menaxhim direkt, i përcillet Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri;

b) Për dokumentet e veprimit që do të zbatohen me menaxhim indirekt me strukturat kombëtare, i përcillet Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve (CFCU);

c) Për dokumentet e veprimit që do të zbatohen me menaxhim indirekt me një palë të besuar nga Komisioni, i përcillen organizatës/institucionit të cilit i është besuar zbatimi i dokumentit të veprimit.

Autoriteti kontraktues certifikatën e lëshuar nga SASPAC ia përcjellë zbatuesit/përfituesit të projektit.

2. Në rastin e Programeve Operacionale, pas përfundimit të procedurave të brendshme për miratimin e Marrëveshjes Financiare të Programit dhe hyrjes në fuqi të saj, drejtorja përgjegjëse për administrimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian pranë SASPAC, në rolin e Zyrës Mbështetëse të Koordinatorit Kombëtar IPA, i drejton SASPAC kërkesën për regjistrimin dhe lëshimin e certifikatës për këtë program, duke i vënë në dispozicion:

a) Kopje të aktit të miratimit të Marrëveshjes Financiare të Programit;

b) Kopje të programit të miratuar për të cilin do të lëshohet certifikata.

Pas lëshimit të certifikatës, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, SASPAC ia përcjellë Autoritetit Menaxhues dhe Organit të Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar (ONMF)/Autoritetit Kontraktues të Programit.

Autoriteti Menaxhues dhe Organi i Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar (ONMF)/Autoriteti Kontraktues i Programit certifikatën e lëshuar nga SASPAC ia përcjellë zbatuesit/përfituesit të programit.

3. Në rastin e programeve rajonale të cilat zbatohen direkt nga Komisioni Evropian apo nga një palë të cilës i është besuar nga Komisioni Evropian zbatimi i programit, Komisioni Evropian/Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri regjistrojnë projektin në SASPAC duke paraqitur:

a) Kërkesën me shkrim;

b) Njoftimin zyrtar mbi pranueshmërinë e Shqipërisë për të qenë pjesë e programit, bazuar në kriteret e pranueshmërisë;

c) Dokumentin identifikues të programit në përmbajtje të të cilit janë të dhënat bazë mbi programin, duke përfshirë përshkrimin e programit, informacionin mbi zbatuesin, afatet kohore;

d) Kopje të aktit me të cilin është miratuar projekti, pjesë e programit;

e) Çdo dokument tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga SASPAC.

SASPAC vlerëson kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur dhe nëse është i plotë, lëshon Certifikatën e Regjistrimit të Programit/Projektit, në drejtim të Komisionit Evropian/Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, SASPAC njofton menjëherë Komisionin Evropian/Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e tyre, brenda një afati 10-(dhjetë-)ditor.

Komisioni Evropian/Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri certifikatën e lëshuar nga SASPAC, ia përcjellë zbatuesit/përfituesit të projektit.

4. Në rastin e programeve të Bashkimit Evropian, pas përfundimit të procedurave të miratimit të projekteve për secilën thirrje të programit, institucioni i cili është në rolin e Koordinatorit Kombëtar të programit regjistron projektin në SASPAC, duke paraqitur:

a) Kërkesën me shkrim;

b) Referencën ligjore për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Shqipërisë në një program të caktuar;

c) Listën e projekteve të miratuara në të cilat janë përfitues edhe palë nga Shqipëria (institucioni, organizata, entiteti);

d) Kopje të aktit me të cilin është miratuar projekti;

e) Kopje të Marrëveshjes së Partneritetit midis palës shqiptare dhe palëve të tjera përgjegjëse për zbatimin e projektit;

f) Çdo dokument tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga SASPAC.

SASPAC vlerëson kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga institucioni koordinues i programit dhe nëse është i plotë, lëshon Certifikatën e Regjistrimit të Programit/Projektit brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, SASPAC njofton menjëherë institucionin koordinues të programit për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e tyre, brenda një afati 10-(dhjetë-)ditor.

Institucioni koordinues i programit certifikatën e lëshuar nga SASPAC ia përcjell zbatuesit/përfituesit të projektit.

5. Në rastin e programeve IPA të Bashkëpunimit Ndërkufitar, pas përfundimit të procedurave të miratimit të projekteve për secilën thirrje të programit, Autoriteti Menaxhues/Autoriteti Kontraktues i programit regjistronë projektin në SASPAC, duke paraqitur:

- a) Kërkesë me shkrim;
- b) Kopje të kontratës/marrëveshjes, të nënshkruar nga Autoriteti Menaxhues/Autoriteti Kontraktues dhe përfituesi i projektit, ku përmenden të gjithë partnerët shqiptarë në këtë projekt;
- c) Kopje të Marrëveshjes së Partneritetit midis palës shqiptare dhe palëve të tjera përgjegjëse për zbatimin e projektit;
- d) Çdo dokument tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga SASPAC.

SASPAC vlerëson kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga Autoriteti Menaxhues/Autoriteti Kontraktues i Programit dhe nëse është i plotë, lëshon Certifikatën e Regjistrimit të Programit/Projektit, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, SASPAC njofton menjëherë Autoritetin Menaxhues/Autoritetin Kontraktues i Programit për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e tyre, brenda një afati 10--(dhjetë-)ditor.

Autoriteti Menaxhues/Autoriteti Kontraktues i Programit certifikatën e lëshuar nga SASPAC ia përcjell zbatuesit/përfituesit të projektit.

6. Për të gjitha rastet e parashikuara në këtë nen, certifikata përmban elementet, si: emërtimi i programit/projektit, data e fillimit dhe data e përfundimit të programit/projektit, vlera fillestare e financimit të programit/projektit, të dhënat e zbatuesit dhe përfituesit të programit/projektit, si dhe Kodin Unik të Identifikimit të Programit/Projektit, të lëshuar nga SASPAC për këtë qëllim.

SASPAC, një kopje të certifikatës së regjistrimit të programit/projektit, së bashku me kopje të dokumentacionit të parashikuar në secilin rast më sipër, ia dërgon menjëherë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD).

Në rast të ndryshimit të kushteve të marrëveshjes dhe/ose programit/projektit, autoriteti apo institucioni që ka bërë kërkesën duhet të njoftojë SASPAC, brenda një afati 10-(dhjetë-)ditor. Në këtë rast, SASPAC reflekton ndryshimet në certifikatën e lëshuar dhe ia dërgon menjëherë DPT-së dhe DPD-së. Procedurat e detajuara të verifikimit të transaksioneve, kontrollit të tyre dhe rimbursimit të kontraktorëve për rastet kur plotësohen kriteret ligjore, detajohen nga DPT-ja në pjesën e Manualit të Kontrollit të dedikuar për këto transaksione dhe subjekte.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT TË PROGRAMIT/PROJEKTIT

EMËRTIMI I PROGRAMIT/PROJEKTIT

TË DHENA PËR ZBATUESIN / PËRFITUESIN E PROGRAMIT/PROJEKTIT

DATA E FILLIMIT
TË PROGRAMIT/PROJEKTIT

DATA E PËRFUNDIMIT
TË PROGRAMIT/PROJEKTIT

VLERA FILLESTARE E FINANCIMIT TË PROGRAMIT/PROJEKTIT

REFERENCAT LIGJORE

KODI UNIK

DATA E LËSHIMIT

DATA E RISHIKIMIT



DREJTORI PËRGJITHSHËM
(firmë dhe vulë)

*Në rast të ndryshimit të marrëveshjes dhe/ose programit/projektit, zbatuesi/përfituesi i projektit duhet të njoftojë SASPAC, brenda një afati 5 (pesë) ditor.



Drejtoria e
Përgjithshme e
Tatimeve

**CERTIFIKATË REGJISTRIMI TË
PROJEKTIT/KONTRATËS PËR EFEKT TË TRAJTIMIT SI
FURNIZIM I PËRNGJASHËM ME EKSPORTET**

Formular 7A

DREJTORIA RAJONALE TATIMORE _____				
Numri i Certifikatës në regjistrin e DRT-së: _____				
1. Emri i zbatuesit të projektit:		2. NIPT:		
3. Data e fillimit të projektit/kontratës:		4. Data e mbarimit të projektit/kontratës:		
5. Titulli i projektit/kontratës:		6. Donatori i grantit:		
7. Lista e bashkëaplikuesve në certifikatë				
Statusi në kontratë	Emri	NIPT	Kontrata	Kontrollori/konfirmuesi i shpenzimeve
Kontraktor 1	xxxxx	yyyyyy		
Kontraktor 2				
.....				
8. Marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar që parashikon mospërdorimin e fondeve për të paguar tatime (referenca e nenit dhe ligjit ratifikues)				

DREJTORI	
Nënshkrimi: _____	Data: _____